



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA

Nr. 452/1 prot.

Elbasan, më 5.4.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.29 datë 26.03.2025, " Propozim për dhënien e statusit Dëshmor i Atdheut të ndjerit Muharrem Ferit Hidri", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA



452
01.4.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.28.03.2025

Nr.1764 prot

Nr.29 dt.26.03.2025

**PROPOZIM PËR DHËNIEN E STATUSIT DËSHMOR I ATDHEUT TË NDJERIT
MUHARREM FERIT HIDRI**

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" datë 17.12.2015, ligjit nr. 109/2018 date 20.12.2018 "Për statusin e deshmorit te Atdheut" kreu III, neni 10 dhe neni 11, si dhe ne ne kerkesen e z. Avni Hidri (vëllai i të ndjerit) datë 26.09.2024 nr. Prot.4569. Këshilli Bashkiak I mbledhur sot me date 26.03.2025 pasi mori në shqyrtim kërkesën e sipër përmendur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Ti propozojë Komisionit Qëndror për Statusin "Dëshmori i Atdheut" pranë Ministrisë së Mbrojtjes, dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut" të ndjerit Muharrem Ferit Hidri për shkak të vdekjes në krye të "detyrës luftarake" në date 17.01.1977 në pozicionet e zjarrit të ish Repartit Ushtarak nr.9125 të rrethit Vlorë;
2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Bashkia Librazhd
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes .

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU



30.9.2024

4569

DT 26.09.2024

Këshilli Bashkiak

KERKESE

BASHKISE

Drejtuar/ KËSHILLIT TË QYTETIT PRANË BASHKISE LIBRAZHD



Une i quajtur i Avni Ferit Hidri lindur në Dorëz njesia administrative Qendër me datëlindje 30.04.1964, banues Lagjia Nr.2 qytetit Librazhd, vëlla i të rënit Muharrem Hidri, mbështetur në Udhëzimin Nr.1803 dt.10.06.2002 "Për zbatimin e VKM nr.151 dt.25.04.2002 "Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut" po ju paraqes kërkesën time për njohjen e statusit të "Dëshmorit të Atdheut".

I rëni Muharrem Ferit Hidri lindur më 20.09.1954 në Dorëz të rrethit Librazhd ka vdekur në krye të detyrës gjatë kohës së kryerjes së shërbimit ushtarak në periudhën 09.01.1975 deri 16.01.1977 pranë Repartit Ushtarak 9125 Regjiment i Artilerisë Bregdetare pranë "Kepit Gjuzës" Orikum të rrethit Vlorë.

Për të vërtetuar këtë fakt nga ana ime janë ndjekur të gjitha proedurat ligjore, për fakti se i rëni Muharrem Hidri figuronte i gjallë në regjistrat e gjëndjes civile. Kjo më dha indicjen për të zbuluar shkakun e vdekjes së të rënit, ku më rezultoi se ai kishte vdekur gjatë kohës që ishte në shërbim ushtarak. Pas kësaj i jam drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Përgjithshëm për të vërtetuar faktin juridik të rënies në krye të detyrës.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me vendimin e saj Nr.493 (13-2024-1537) date 04.04.2024 ndër të tjera ka vendosur: **Vërtetimin e faktit juridik të vdekjes në krye të "detyrës luftarake" te shtetasit Muharrem Ferit Hidri më date 17/01/1997, në pozicionin e zjarrit të ish Repartit Ushtarak Nr.9125 të rrethit Vlorë.** Ky vendim ka marrë formën e prerë date 18.07.2024.

Nisur nga sa referova më lartë po ju drejtohem me këtë kërkesë për t'u marrë në shqyrtim nga ana e juaj që i rëni Muharrem Ferit Hidri të shpallet Dëshmor i Atdheut si dhe njohjen nga ana juaj e Statusit të dëshmorit të Atdheut.

Kërkuesi Avni Ferit Hidri

Adresa: Lagjia Nr.2 qytetit Librazhd.

Bashkëlidhur po ju ve në dispozicion këto dokumenta:

1-Certifikate familjare e Ferit Hidri. ✓

2-Certifikate vdekje e Muharrem Hidri. ✓

3-Vendimi Nr.493 (13-2024-1537) date 04.04.2024 e Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Elbasan. ✓

4-Praktika me aktet shkresore e paraqitur në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Shkallës së Parë të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____/03/2025

PROPOZIM PËR DHËNIEN E STATUSIT DËSHMOR I ATDHEUT TË NDJERIT MUHARREM FERIT HIDRI

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" datë 17.12.2015, ligjit nr. 109/2018 date 20.12.2018 "Për statusin e deshmorit te Atdheut" kreu III, neni 10 dhe neni 11, si dhe ne kerkesen e z. Avni Hidri (vëllai i të ndjerit) datë 26.09.2024 nr. Prot.4569. Këshilli I Bashkisë Librazhd pasi mori në shqyrtim kërkesën e sipër përmendur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkise ne mbledhjen e dates ____/03/2025,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Komisionit Qëndror për Statusin "Dëshmori i Atdheut" pranë Ministrisë së Mbrotjtjes, dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut" të ndjerit Muharrem Ferit Hidri për shkak të vdekjes ne krye te "detyres luftarake" në datë 17.01.1977 në pozicionet e zjarrit të ish Repartit Ushtarak nr.9125 të rrethit Vlore;
2. Ndjek zbatimin e ketij vendimi Bashkia Librazhd;
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes .

KRYETARI I BASHKISË
MARIGLEN DISHA

Sen 30.9.2024

Këshilli Bashkiak

KERKESE

4569
Dt 26.09.2024

BASHKISE

Drejtuar/ KËSHILLIT TË QARKUT PRANË BASHKISE LIBRAZHD



Une i quajtur Avni Ferit Hidri lindur në Dorëz njesia administrative Qendër me datëlindje 30.04.1964, banues Lagjia Nr.2 qytetit Librazhd, vëlla i të rënit Muharrem Hidri, mbështetur në Udhëzimin Nr.1803 dt.10.06.2002 "Për zbatimin e VKM nr.151 dt.25.04.2002 "Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut" po ju paraqes kërkesën time për njohjen e statusit të "Dëshmorit të Atdheut".

I rëni Muharrem Ferit Hidri lindur më 20.09.1954 në Dorëz të rrethit Librazhd ka vdekur ne krye të detyrës gjatë kohës së kryerjes së shërbimit ushtarak në periudhën 09.01.1975 deri 16.01.1977 pranë Repartit Ushtarak 9125 Regjiment i Artilerise Bregdetare pranë "Kepit Gjuzës" Orikum të rrethit Vlorë.

Për të vërtetuar këtë fakt nga ana ime janë ndjekur të gjitha proedurat ligjore, për fakti se i rëni Muharrem Hidri figuronte i gjallë në regjistrat e gjëndjes civile. Kjo më dha indicjen për të zbuluar shkakun e vdekjes së të rënit, ku më rezultoi se ai kishte vdekur gjatë kohës që ishte në shërbim ushtarak. Pas kësaj i jam drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Përgjithshëm për të vërtetuar faktin juridik të rënies në krye të detyres.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me vendimin e saj Nr.493 (13-2024-1537) date 04.04.2024 ndër të tjera ka vendosur: **Vërtetimin e faktit juridik të vdekjes në krye të "detyrës luftarake" te shtetasit Muharrem Ferit Hidri më date 17/01/1997, në pozicionin e zjarrit të ish Repartit Ushtarak Nr.9125 të rrethit Vlorë.** Ky vendim ka marrë formën e prerë date 18.07.2024.

Nisur nga sa referova më lartë po ju drejtohem me këtë kërkesë për t'u marrë në shqyrtim nga ana e juaj që i rëni Muharrem Ferit Hidri të shpallet Dëshmor i Atdheut si dhe njohjen nga ana juaj e Statusit të dëshmorit të Atdheut.

Kërkuesi Avni Ferit Hidri

Adresa: Lagjia Nr.2 qytetit Librazhd.

Bashkëlidhur po ju ve në dispozicion këto dokumenta:

1-Certifikate familjare e Ferit Hidri. ✓

2-Certifikate vdekje e Muharrem Hidri. ✓

3-Vendimi Nr.493 (13-2024-1537) date 04.04.2024 e Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Elbasan. ✓

4-Praktika me aktet shkresore e paraqitur në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Adresa: Lagjia Nr.2 qytetit Librazhd

Librazhd, më _____._____.2024

KËRKUESI

Avni HIDRI

Avni Hidri
Ref.

**Dokumentat që do të dorëzohen pranë Sekretarisë së bashkisë dhe Këshillit Bashkiak
Librazhd për njohjen e “Dëshmor i Atdheut” dhe statusin shtetasit**

Muharrem Ferit Hidri.

1. Vendim gjykate i formës së prerë nr.493 (13-2024-1537) - fletë 5(pesë)
2. Certifikatë familjare
 - 2.1 Certifikatë vdekje datë 11.09.2024
 - 2.2 Certifikatë negative datë 07.06.2021
 - 2.3 Certifikatë familjare datë 07.06.2021
 - 2.4 Certifikatë Personale datë 07.06.2021 fletë 5(pesë)
3. Shkresa nr.347/2 Prot datë 21.01.2021 Ministria e Mbrojtjes,Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm. Dokumenta të deklasifikuara fletë 8(tetë).
 - 3.1.Telegram datë 17.01.1977
 - 3.2 Proces verbal datë 17.01.1977
 - 3.3 Kërkesë nr. 57/1 prot. Datë 08.03.1977 e cikluar secrete dhe ekzemplar nr.1
 - 3.4 Telegram datë 03.02.1977
 - 3.5 Telegram datë 03.02.1977 Sotir Prifti
 - 3.6Relacion nr.13 prot. Për korpusin e Fierit datë 18.05.1977 fletë 3 shuma 8 fletë
4. Shkresa nr.6368 prot. Datë 23.05.2017, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura – Kthim përgjigje fletë 3(tre)
5. Vërtetim 25.10.2016 prot. 25/4 Shtabi I Përgjithshëm i Forcave të Armatosura ,Qendra e Personel Rekrutimit – fletë 1(një)
6. Shkresë nr.757/1 prot. 16.05.2017 -Arkivi Qendror I Forcave të Armatosura- fletë 2 (dy)
7. Kthim përgjigje nr.123 , regjistruar 10.04.2017 nr.K2/A4-5 PROT.20.04.2017-Avokati i Popullit- fletë 3(tre)
8. Proces – verbal kallzimi Vepër penale datë 16.07.2017 – fletë 2 (dy)
 - 8.1 Njoftim nr.prot. 752 datë 22.11.2014
 - 8.2 Vendim prokurorise 23.06.2017 fletë 3 (tre)
9. Kthim përgjigje nr.480-3 prot.datë 04.08.2016 – fletë 2 (dy)
 - 9.1. Nr.692/1 prot. Datë 28.04.2017 - 1(një) fletë
 - 9.2. nr.122/1 prot datë 03.04.2017 fletë 2 (dy)
 - 9.3 Nr.41/2 prot datë 02.02.2018 fletë 1
 - 9.4 7/A PROT DATË 24.01.2018 9 (nëntë) fletë
 - 9.5. Nr.4319/2 prot. 29.01.2021 shoqëruar me shkresën 347/1 prot 21.01.2021 fletë 2(dy)
10. Kërkesë drejtuar Kryeministrit, Presidentit,Ministrit të Mbrojtjes,Shefit të Shtabit të Përgjithshëm datë 17.01.2018 – fletë 2 (dy)
11. Deklaratë noteriale -Nebi Çela Vlorë datë 27.02.2017 nr.167REP 131 Kol Haki Boçi datë 27.02.2017 168 rep 132 kol Vlorë - fletë 5(pesë)

(Marë në dorëzim)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN

NR. REGJ. THEM	210 (21236 - 05022-13-2021)/44/22/21	Datë 08/07/2021
NR. VENDIMIT	493 (13 - 2024- 1537)	Datë 04/04/2024

V E N D I M

“ NË EMËR TË REPUBLIKËS ”

Gjykata e shkallës parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e përbërë nga :

Gjyqtare : IDUSH MALIQI

Asistuar nga *sekretare gjyqësore Erisa Çili* sot më datë **04.04.2024** mori në shqyrtim në seancë publike, çështjen civile me **Nr. 210(21236-05022-13-2021)/44/22/21**, që i përket:

KËRKUES :

Avni Hidri i biri i Feritit dhe i Florindës ,i dtl.30/04/1964, lindur në fshatin Dorëz Librazhd dhe banues në Librazhd ,lagja nr 2,pallati 13 ,madhore dhe e aftë për të kryer veprime juridike ,mbajtës i dokumentit identifikues letërnjotim me nr 0360063493,nr personal G40430067R përfaqësuar nga av.Qani Hasa,DhomaAvokatisë Elbasan.

PERSONA TË TRETË : 1.Zyra e Gjendjes Civile Librazhd.
2.Ministria e Mbrotjes e Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTI :

Vërtetim i faktit juridik të vdekjes të shtetasit Muharrem Ferit Hidri më datë 16/01/1977 në krye të detyrës luftarake.

Baza ligjore:

Neni 388 të Kodit të Proçedurës Civile.Ligji për gjendjen civile nr 10129 ,dt/11/05/2009 i ndryshuar ,ligji 5592dt/15 /06/1997" Mbi shërbimin ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës Popullore të Shqipërisë" neni 11 i tij.

Në përfundim të gjykimit palët ndërgjyqesë kërkuar :

Kërkuesi nëpërmjet avokatit të tij kërkoi; Pranimin e kërkesës.

Nëpërmjet kësaj kërkesë kërkohet në rrugë gjyqësore, të vërtetohet gjyqësisht fakti i vdekjes së shtetasit Muharrem Ferit Hidri, pasi ky shtetas nuk është i çrregjistruar nga rregjistrat e Zyrës së Gjendjes Civile Librazhd dhe ai figuron si i gjallë.

Zyra e Gjendjes Civile Arkiva, Qarku Elbasan, Rrethi Librazhd nëpërmjet punojtes përkatëse të kësaj zyre me aktin Çertifikatë Negative datë 07/06/2021 konfirmon se: *"Unë Vjollca Vreto, punonjëse e gjendjes civile pranë nënprefekturës Librazhd, pas kontrollit të dokumentacionit në zyrën tonë, librave të akteve të vdekjeve nga viti 1977 deri në vitin 2014, Librazhd, vërtetojmë se Muharrem (Ferit, Xhike) Hidri, datëlindje 20/09/1954, vendlindje Dorëz, nuk ka akt vdekje"*

Neni 388 të Kodit Proçedurës Civile thuhet: "kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë."

Pra kushti kryesor për të kërkuar vërtetimin gjyqësor të fakteve është mungesa e aktit që vërteton lindjen, vdekjen, ndryshimin ose shuarjen e të drejtave personale apo pasurore.

Mungesa e këtyre akteve e pengon kërkuesin të realizojë të drejtat e tij, pasi pronat janë në emër të trashëgimtarëve që dalin nga dëshmia e trashëgimisë të prindërëve të tij, po nga këto akte varet dhe realizimi i të drejtave të tjera ligjore pasurore ose jo pasurore.

Ky fakt nuk mund të vërtetohet në rrugë tjetër pasi akti zyrtar me anë të cilit mund të përcaktohet fakti i kërkuar që është fakti i vdekjes dhe përcaktimi i datës së vdekjes nuk mund të bëhet përsëri dhe nuk mund të merret në asnjë rrugë tjetër.

Aktet zyrtare në lidhje me lindjen e vdekjen e një personi janë ekskluzivitet vetëm i Zyres së Gjendjes Civile. Vetëm nga ky institucion është organi kompetent nga ku mund të nxirren aktet që kanë të bëjnë me identitetin e shtetasit dhe ekzistencën e tij.

Meqenëse nga kjo zyrë është paraqitur akti negativ kërkuesit i vdekjes së kërkuesit, pasi ai figuron i rregjistruar si shtetas, po nuk figuron i çrregjistruar si i vdekur e për rrjedhojë ai nuk ka as datë vdekje, pra në këtë mënyrë trashëgimtarëve të tij u është mohuar e drejta nga kjo zyrë duke bërë të pamundur për të pasur çertifikatë vdekje kërkuesin vëllain e tij.

Kështu kërkuesi shpjegoi në gjykatë se, unë kërkuesi Avni Hidri jam banorë i qytetit Librazhd fakt ky që vërtetohet nga çertifikata familjare me nr 017267010 dt 07.06.2021 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Librazhd. Unë kam pasë një vëlla të quajtur Muharrem Hidri i datëlindjes 20.09.1954. Vëllai im i ndierë Muharrem Hidri nga data 09.01.1975 deri me dt 16.01.1977 ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak në Repartin Ushtarak nr 9125 Orikum Vlorë, në Regjimentin e Artilerisë Bregdetare "Kepi i Gjuzës", vëllai im ka qenë duke kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak në këtë repart 3 vjeçar.

Më dt. 17.01.1977 në shtëpinë tonë vjen një bashkëfshatar i jonë i quajtur Rexhep Hoxha dhe na ka dhënë lajmin, e vdekjes në krye të detyrës, të vëllait tonë Muharrem Hidri dhe për këtë arsye duhet të merreshin masat përkatëse.

LBASAK

këtyre shkresave vihem në dijeni se me vendimin nr 74 dt.05.10.2020 Arkivi Qëndror i Forcave të Armatosura ka deklasifikuar dosjen dhe dokumentacionin e kërkuar nga unë. Pas deklasifikimit të informacionit ne na janë vënë në dispozicion një pjesë e dokumentacionit dhe që janë:

1. Një telegram i datës 17.01. 1977 i dërguar nga Komanda e Repartit Ushtarak nr 9125 dërguar Komitetit Ekzekutiv të K. P. R Librazhd dhe Degës Ushtarake Librazhd dhe Këshillit Popullor për vdekjen e vëllait: Muharrem Hidri . Në këtë telegram thuhet “ *Ushtari Muharrem Ferit Hidri efektiv i Repartit Ushtarak nr 9125 Vlorë dhe me banim ne lagjen Nr 2, apartamenti 13, Librazhd vdiq në krye të detyrës ushtarake* “
2. Një procesverbal dt.17.01.1977 i mbajtur nga një komision i Repartit Ushtarak nr 9125 për vdekjen e vëllait tim Muharrem Feri Hidri për efekt pensioni.
3. Një shkresë me nr 57/1 dt.08.03.1977 e Rep Ushtarak 9125 dërguar Degës Ushtarake Librazhd ku sipas të cilës rezulton se kësaj dege i janë dërguar procesverbali dhe dokumentat mbi vdekjen e ushtar Muharrem Ferit Hidri, ku thuhet “ *Ngjitur leja e varrimit lëshuar nga mjeku ligjor* “ ,leje varrimi që nuk na është vënë në dispozicion asnjëherë. Kjo shkresë përmban shënimin ekzemplar nr 1 dhe sekret.
4. Dy telegrame dërguar nga Dega e Ushtarake Librazhd repartit 9125 , ku kërkohet procesverbali i vdekjes dhe dokumentacioni i vdekjes nga Dega Ushtarake Librazhd pasi ky dokumentacion kërkohet nga Zyra e Gjendjes Civile Librazhd për të kryer veprimet përkatëse.
5. Një relacion që Komanda e Repartit Ushtarak nr 9125 i dërgon Komandës së Repartit Ushtarak 6561 Fier (që ishte Komanda eprorë) .

Megjithëse na janë dhënë disa dokumenta ne nuk na janë vënë në dispozicion shumë dokumenta të tjera si.

Kartela personale e ushtarit , ose procesverbali i asgjësimit të saj, detyrim ligjor për tu dhënë .

1. Akt ekspertimi mjeko ligjor dhe asnjë lloj dokumentacioni që ka të bëjë me vendin e ngjarjes fotografi të tij ,apo fotografi të vëllait tonë në vendngjarje, si dhe akti i vdekjes me nr 384 dt 16.01.1977.
2. Mungon motivacioni i vdekjes akt që duhet të ishte patjetër në dosje , një kopje e të cilit i është dhënë familjes.

Mungesa e këtyre dokumentave krijon dyshime pasi sipas shkresës së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura me nr 6368 dt.23.05.2017 konfirmohet se vëllai jonë ka vdekur me dt.16.01.1977 e dhënë kjo e pasqyruar në rregjistrin e vitit lindjes Librazhd akt ky i ndodhur në zyrat e rekrutimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Të gjitha këto pretendime tona vërtetohen me faktin se dosja e vëllait tonë ka qenë një dosje e kalsifikuar si dosje SEKRET SHTETËROR dhe duhet të përmbante të gjithë dokumentacionin e plotë sipas legjislacionit të kohës .

Megjithëse dosja është deklasifikuar përsëri ajo ka shumë pika të errta që nuk marrin

Konkluzionet e gjykatës .

Gjykata në analizë të detajuar të shpjegimeve të palëve , vlerëson se kërkesa e kërkuarit është e drejtë dhe e bazuar në ligj për këto arsye :

1. Gjendjes Civile Arkiva , Qarku Elbasan ,Rrethi Librazhd me Çertifikatë Negative datë 07/06/2021 konfirmon se : "*pas kontrollit të dokumentacionit në zyrën tonë ,librave të akteve të vdekjeve nga viti 1977 deri në vitin 2014 ,Librazhd ,vërtetojmë se Muharrem (Ferit ,Xhike)Hidri ,datëlindje 20/09/1954 ,vendlindje Dorëz ,nuk ka akt vdekje "*.

Pra vërtetohet fakti se për vëllain e kërkuarit nuk ka akt vdekje në mënyrë që ai të ishte çregjistruar nga rregjistrat përkatës të gjendjes civile Librazhd .Ky akt që në atë kohë i është kërkuar komandës së repartit ku vëllai i kërkuarit ka qenë duke kryer shërbimin ushtarak dhe ai nuk i është dërguar ,zyrës përkatëse të gjendjes civile .Po ashtu nga një numër i madh dokumentash vërtetohet vdekja e tij ,po akt vdekje për këtë shtetas nuk është plotësuar ,dhe për këtë fakt nuk ka asnjë lloj shpjegimi .

2. Në këto kushte kërkesa për vërtetimin e faktit juridik për sa i përket datës së vdekjes së këtij shtetasi është e drejtë dhe e bazuar në ligj pasi ky fakt nuk mund të vërtetohet në asnjë rrugë tjetër veç asaj gjyqësore ,pasi nga një shkresë e sipërcituar përmendet fakti i egzistencës së një akti vdekje me nr 384 dt.16.01.1977, akt ky që nuk i është vënë asnjëherë në dispozicion Zyrës së Gjendjes Civile Librazhd ,po ashtu nga shkresa e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura me nr 6368 dt.23.05.2017 konfirmohet vdekja e vëllait të kërkuarit me dt.16.01.1977 e dhënë kjo e pasqyruar në rregjistrin e vitlindjes Librazhd , akt ky i ndodhur në zyrat e rekrutimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Nga vërtetimi i këtij fakti juridik trashgimatarët tërheqin interesa.

Në këtë mënyrë pranohet çdo kërkesë e kërkuar nga neni 388 i K. Pr. Civile , pasi as nga aktet e reja të sjella në seancë gjyqësore nuk vërtetohen dhe nuk plotësohet asnjë kërkesë e kërkuar nga kërkuari .

- 3.Në lidhje me kërkimin e kërkuarit për vërtetimin e faktit juridik motivacionit apo shkakut të vdekjes së ushtar Muharrem Hidri ka rënë në krye të detyrës luftarake.

Gjykata në analizë të provave që i janë vënë në dispozicion po dhe nga dëshmiat të pyetur , arrin në përfundimin se ushtar Muharrem Hidri , ka vdekur në krye të detyrës luftarake dhe ky është dhe motivacioni i vdekjes së tij që duhet të vërtetohet nga gjykata pasi ka një numër të madh dokumentash që vërtetojnë një motivacion të tillë e konkretisht ;

- 1.Telegram i datës 17.01.1977 i ish Repartit Ushatarak nr 9125 dërguar Komitetit Ekzekutiv K.P Rrethit Librazhd , Degës Uushtarke Librazhd, në të cilin thuhet "*Ushtari Muharrem Ferit Hidri efektiv i Repartit Ushatarak Nr 9125 Vlorë*

6. Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë me nr 785/1 dt.24.11.2016 Sektori 1 Inspektimit të Prokurorisë.
7. Proçesverbal për kallzimin e veprës penale dt.16.06.2017 .
8. Vendim “për mosfillimin e Proçedimit Penal “ datë 23.06.2017 .
9. Shkresë e avokatit të popullit me nr 123 dt 10.04.2017 dhe shkresë me nr K2/A4-5 dt.20.04.2017 .
10. Shkrese e Ministrisë së Brendëshme nr 122/1 dt.03.04.2017 me lëndë " Kthim përgjigje"
11. Shkrese e Ministrisë së Mbrojtjes e Arkivit Qëndror të Forcave të Armatosura, bashkangjitur informacioni dt.17.01.1977.
12. Shkresë e Ministrisë së Mbrojtjes Nr 41/2 dt.02.02.2018 .
13. Shkresë e Insitucionit të Presidentit të Republikës 7/A dt.24.01.2018 dhe shkresa nr 286/1 dt.31.01.2020 dhe nr 4319/2 dt.29.01.2021 , bashkangjitur shkresa me nr 347 dt.21.01.2021 .
14. Shkrese me nr 692/1 dt.28.04.2017 i Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale .
15. Shkresë e Ministrisë së Mbrojtjes me nr 347/2 dt.21.01.2021 ,bashkangjitur Telegram dt 17.01.1977 i ish repartit ushtarak 9125 , proçesverbal dt 17.01.1977 i mbajtur nga komisioni i Ngritur nga Reparti Ushtarak 9125 , ku pasqyrohet rrethanat e ngjarjes, Shkresë me nr 57/1 dt.08.03.1977 e Repartit Ushtarak nr 9125,dy telegrame të Degës Ushtarake Librazhd , Relacion i Komandës Repartit ushtarak nr 6561 dt.18.05.1977 ,gjithësej 9 fletë.
16. Deklaratë noteriale me nr.167 Rep e nr.131 Kol dt.27.02.2017 lëshuar nga Nebi Çela.
17. Deklaratë noteriale me nr.168 Rep e nr.132 kol dt.27.02.2017 lëshuar nga Haki Roçi .
18. Shkresa me nr 6368 prot dt 23.05.2017 , kthim përgjigje dhe dy fletë të regjistrimit nga Qendra e personelit rekrutimit ashtu dhe dëshmitarët e pyeturur në seancë gjyqësore

Nga analiza e provave të mësipërme gjykata arrin në përfundimin se shtetasi Muharrem Hidri ka vdekur “në krye të detyrës luftarake” më datë 17.01.1977 në pozicionet e zjarrit të ish repartit ushtarak 9125 të Rrethit Vlorë.

Në rrethanat faktike dhe konkluzionet e mësipërme gjykata arrin nga shpjegimet e kërkuarit ,pohimet e dëshmitarëve dhe provat shkrese të administruara në gjykim e të analizuara më sipër.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata duke parë dhe nenet 213, 302, 305 e vijues të K.Pr.Civile,

VENDOSI

- Pranimin e kërkesës.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Librazhd

Njësia administrative Librazhd 138

Zyra e Gjendjes Civile 138



Datë: 11.09.2024

CERTIFIKATË VDEKJE

Në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, Librazhd nr.4 fleta 384 me reference vërtetohen të dhënat e mëposhtme

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	Muharrem
Mbiemri	HIDRI
Numri Personal	-----
Emri i Babait	Ferit
Emri i Nënës	Xhike
Datëlindja	20-09-1954 (pesëdhjetë e katër)
Vendlindja	Dorëz, Librazhd
Vendbanimi	Librazhd
Gjinia	Mashkull
Gjendja Civile	Beqar/e
Shtetësia	Shqiptare
Data e vdekjes	17-01-1977
Vendi i vdekjes	
Shkaku i vdekjes	

Kjo certifikatë lëshohet për _____ Dokument

Vendim nr.493 (13-2024-1537) datë 04.04.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me objekt "Vërtetim i faktit juridik të vdekjes".

Nëpunësi i Gjendjes Civile

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e
Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date: 2024/09/11 09:28:45 +02'00'
50389d33f12e4883948eb640eb24ab1a

Hyrisiana Balla

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

bashkia Librazhd

Sjësia administrative Librazhd 138

Zyra e Gjendjes Civile 138



Datë: 10.09.2024

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, Librazhd nr.4 fleta 384 me reference vërtetohen të dhënat e mëposhtme

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Ferit HIDRI	Shaban	Kadite	M	Kryefamiljar	17-12-1932	I/e martuar	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
2.	Florinda HIDRI	Hasan	Shygyrrije	F	Bashkëshorte	22-02-1942	I/e martuar	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
3.	Lavdiqe HIDRI	Ferit	Florinda	F	E Bija	20-04-1962	Beqar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
4.	Avni HIDRI	Ferit	Florinda	M	I Biri	30-04-1964	Beqar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
5.	Merita HIDRI	Ferit	Florinda	F	E Bija	22-10-1966	Beqar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
6.	Muharrem HIDRI	Ferit	Xhike	M	I Biri	20-09-1954	Beqar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
7.	Gëzim HIDRI	Ferit	Florinda	M	I Biri	17-03-1969	Beqar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
8.	-----									
9.	-----									
10.	-----									

Kjo certifikatë lëshohet për

Dokument

Nëpunësi i Gjendjes Civile

Përbërja familjare (Me vendim nr.70 datë 21.12.1995 të Kësh.Bashk. Librazhd, Gëzim ka ndryshuar mbiemrin në Diamanti dhe me vendim nr.01 datë 18.01.1996 të Kësh.Bashk. Librazhd Gëzim ka ndryshuar emrin në Xhim)

Hyrisiana Balla

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Vulosur elektronikisht nga Drejtorja e
Përgjithshme e Gjendjes Civile
Data 2024/09/10 14:32:00
96c3b77f6a8b40cab1039e76c6b97af2



Shënim - Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)



016582222



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QARKU Elbasan , RRETHI Librazhd

Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva)

Librazhd . më 7/6/2021

ÇERTIFIKATË NEGATIVE

Unë, Vjollca Vreto, punonjëse e gjendjes civile pranë nënprefekturës Librazhd, pas kontrollit të dokumentacionit në zyrën tonë, librave të akteve të vdekjeve nga viti 1977 deri në vitin 2014, Librazhd, vërtetojmë se Muharrem (Ferit, Xhike) Hidri, datelindje 20.09.1954, vendlindje Dorëz nuk ka akt vdekje.

Ky çertifikatë lëshohet për dokument

Nënpunësi i Gjendjes Civile
Vjollca Vreto

(nënshkrimi, vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 Bashkia Librazhd
 Njësia administrative Librazhd 138
 Zyra e Gjendjes Civile 138



017267010

Date: 07.06.2021

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, Librazhd nr.4 fleta 384 me reference vërtetohen të dhënat e mëposhtme

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Nur Perso
1.	Ferit HIDI	Shaban	Kadife	M	Kryefamiljar	17-12-1932	I/e martuar	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
2.	Florinda HIDI	Hasan	Shygyrje	F	Bashkëshorte	22-02-1942	I/e martuar	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
3.	Lavdiqe HIDI	Ferit	Florinda	F	E Bija	20-04-1962	Begar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
4.	Avni HIDI	Ferit	Florinda	M	I Biri	30-04-1964	Begar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
5.	Merita HIDI	Ferit	Florinda	F	E Bija	22-10-1966	Begar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
6.	Muharrem HIDI	Ferit	Xhike	M	I Biri	20-09-1954	Begar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
7.	Gëzim HIDI	Ferit	Florinda	M	I Biri	17-03-1969	Begar/e	Dorëz, Librazhd	Shqiptare	-----
8.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
9.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
10.	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----

Kjo certifikatë lëshohet për _____ Dokument _____
 perberja familjare 01.01.1980

Nëpunësi i Gjendjes Civile
 Blerta Çota

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vende)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Librazhd

Administrative Librazhd 138

Gjendjes Civile 138



016792042



Date: 07.06.2021

CERTIFIKATË PERSONALE

Në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, Librazhd nr.4 fleta 384 me reference vërtetohen të dhënat e mëposhtme

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	Muharrem
Mbiemri	HIDRI
Numri Personal	-----
Emri i Babait	Ferit
Emri i Nënës	Khike
Datëlindja	20-09-1954 (pesëdhjetë e katër)
Vendlindja	Dorez, Librazhd
Vendbanimi	Librazhd
Gjinia	Mashkull
Gjendja Civile	Beqar/e
Shtetësia	Shqiptare

certifikatë lëshohet për

Dokument

Emri Muharrem Ferit Hidri ne flete familjen e Regj. Themeltar Librazhd 4/384 te vitit 1974,rezulton i regjistruar por nuk ka shenime plotesuese ne rubriken perkatese per arsyen e ç'regjistrimit.

Nëpunësi i Gjendjes Civile

Blerta Çota

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 347/12 Prot.

Tiranë, më 21.01. 2021

Lënda: Kthim përgjigje

Z. AVNI HIDRI

Librazhd

I nderuar z. Hidri,

Në përgjigje të kërkesave tuaja drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, dhe institucioneve të tjera shtetërore, pas deklasifikimit të informacionit, bashkëlidhur ju dërgojmë, dokumentacionin që disponohet në Arkivin Qendror të Ministrisë së Mbrojtjes, gjithsej **8 (tetë)** fletë njehsuar me origjinalin.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

DREJTORI

Në mungesë

SPECIALISTI

Kolonel (R) Perikli Tiko



U r g j e n t :

T E L E G R A M

AKTIVI QENDOR I FA
FONDI RU 9125
VII 1977
DOSJA 23, Fl-1

KOMITETIT EKZEK.K.P.RRETHIT

DEGËS USHTARAKE RRETHIT L I B R A Z H D

Ushtari Muharem Ferit Hidri efektiv i Repartit Ushtarak
No.9125 Vlorë dhe me banim në lagjen Nr.2 apartamenti 13 Librazhd vdiq
në krye të detyrës ushtarake.

Lutemi merëni masa për lajmërimin e familjes mbasi ku-
foma me trupin e tij vinë brënda datës 17-I-1977.

KOMISARI REP.USHT.NO.9125

/ RAMADAN ISMAILI /

Vlorë më 17-I-1977



KOMANDANTI REP.USHT.NO.9125

/ NEBI ÇELA /

ARKIVI QENDOR I FA

PROCES - VERBAL

ARKIVI QENDOR I FA
FONDI 1927
DOSJA 23, Fl-8

Imbajtur sot në datën 17-I-1977 në repartin ushtarak No.9125 të Rethit Vlorë, nga komisioni i përbërë prej komandantit të Repartit ushtarak [redacted], prej shefit të sigurimit të repartit [redacted]

[redacted] si dhe prej shefit të shëndetësisë [redacted] mbi vdekjen e ushtar Muharem Ferit Hidrit nga Rethi Librazhdit Lagje Nr.2 apartamenti 13. me arsim 12 klasë, A.B.R., i D.L.1954, me origjinë shoqërore punor, i transportuar N/arnë nga dega ushtarak Librazhd për të kryer 3 vjet shërbim të detyrueshëm ushtarak në repartin usht.9125 nga data 10-I-1975 dhe vazhonte të kryente shërbimin ushtarak në Rep.9125/5.

Rethanat e ngjarjes: Në datën 16-I-1977 ushtar Muharem Ferit Hidri me urdhër të komandës N/repartit ishte caktuar të bënte shërbim në je pranë pozicioneve të zjarrit; në datën 17-I-1977 ora 5.30' u gjet i vdekur në kanalin e zbrapjes së topit në pozicionin e zjarrit topit IV-t nga përgjegjësi i rojës ushtar [redacted]

Nga verifikimi që u bë kësaj ngjarje doli se ushtar Muharem Hidri për detyrën e caktuar si roje pranë pozicioneve të zjarrit ishte instruktuar nga oficeri i rojes, detyrën e njinte, nga gjëndja shëndetësore - ishte i aftë skishte paraqitur asnjë ankesë, asë në instruktimin e personelit të shërbimit dhe asë gjatë kohës që uvendos në vëndroje, para marrjes shërbimit kishte fjetur mb. 6 orë.

Detyra e rojes në këtë vënd roje ishte të patrullohej para pozicioneve të zjarrit, në fakt ky ushtar duke dashur të hynte në pozicionin e zjarrit të topit IV-tër (në tunel) ka shkar në skrapatin e kanalit të zbrapjes topit dhe duke rënë ishte goditur në kokë në pjesën e mbrapme, nga kjo goditje shënja të jashtëme nuk kishte, por vetëm rrjedhje gjaku nga hundët dhe veshi i majt.

Kufomes mbasi ju bë autopsija dolli se në bazën e poshtëme të kokës kishte frakturë dhe emoragji në tru.

Gjatë kohës së shërbimit ushtarak ky ushtar është karakterizuar nga disiplina e ndërgjegjshme nga dashuria për shokët dhe spropet dhe puna e palodhur për zbatimin e detyrave.

Duke unisur nga keto cilësi dhe rrethanat e ngjarjes, komisioni e vlerëson se: Ushtar Muharem Ferit Hidri vdiq aksidentalisht në krye të detyrës.

Mbahet ky proces verbal në 4 kopje për efekt pensioni.

ARKIVI QENDOR I FA

K O M I S J O N I

A N T A R
(Njazi Sinani)

KRYETAR KOMISJONI
(Nebi Celina)

A N T A R
USHTAR (Shaqip Haxhia)

ARKIVI QENDROR I FA
FONDI RU 9125
V. 1977
DOSJA 23, Fe - 78

162

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE SHQIPËRISE
MINISTRIJA MBROJTJES POPULLORE
KOMANDA REPARTIT USHT.NO.9125

SEKRETE

Ekzemplar Nr. 1

Vlor, më 8.3. 977

Nr. 57/1 Prot.

E DEKLASIFIKUAR
Vendimi nr. 74, datë 05.10.2020

DEGES USHTARAKE TE RRETHIT

LIBRAZH D

Bashkangjitur ju dërgojmë proces verbalin dhe dokumentat, mbi vdekjen aksidentale të ushtar Muharem Ferit Hidrit lindur në katundin Dorzë dhe banues në lagjen No.2 apartamenti No.13 të atij Rethi. Ngjitur leja e varimit lëshuar nga mjeku ligjor.

KOMISARI REP.USHT.NO.9125

/RAMADAN ISMAILI/

Ramadan Ismaili

KOMANDANTI REP.USHT.NO.9125

/NEBI CELA/

Nebi Cella



ARKIVI QENDROR I FA

Muhamet Vepri
Dorze

Drejtimi Komandës R. g. usht N 1125
Vlore

Administrata P. T.

Telegram

5-20
20

Lokali Nr.

Marrë data 4/2 - a 14²⁰

Proj zyrtar Shkelle

Marrëel R. g. :

ARKIVI QENDROR I FA
FONDI 219125
VITI 1977
DOSJA 23, Fl-6



Vula datore

Cilësi	Për	Proj	Nr.	Fjalë	Data	Ora	Shënime të shprehimit
	Shkelle	Librashkole	027	41	3/2	a 0800	

Lutemi na dergoni proces verbalin e vendimit se ushtr
Muharrem Ferit Hidi pe eshte caktuar i Regjistrat tuc
Kete e kerkoni dhe gjendje qvite per te ber
Ceregjistrimin

Shefi deges ushtarakre (Sotir pristi)

15 K. P. 14 i Regjistrat tuc Kete e kerkoni

ARKIVI QENDROR I FA

Drejtimi .

Kom. Rep. ult
9125

ARIVI QENDROR I FA
FONDI RU 9125
V.I. 1977
DOSJA 23, FC-6

Lokali Nr.

1030

Marrë data

Pre zyrës

Marrësi

31 7 74



Vula datore

tf 6

Cilësi	Për	Prej	Nr.	Fjalë	Data	Ora	Shënime të shërbimit
5	Orikun	Librazhd	027	41	3/11	8	

Lutemi na ofrojeni proces verbal në
shprehjes së ushtar Muhareze Ferit H. di po është
efektiv raportit tuaj këto e kërkon dhe gjendje
të cilës për të për të regjistruar

Shefi i departamentit
(Lotik Prifti)

CG. 115

ARKIVI QENDROR I FA

E DEKLASIFIKUAR

Vendimi nr. 74, datë 05.10.2020

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE

MINISTRIA E MBROJTJES POPULLORE

KOMANDA E REPARTIT USHT.9I25

Nr. 13 Prot.

Ekzemplar Nr. 1

Vlorë, më 18.5. 1977

L e n d a : Dërgim Relacioni.

KOMANDËS REPARTIT USHTARAK 6561

F I E R

R E L A C I O N

MBI VDEKJEN AKSIDENTALE TË USHTAR MUHAREM

FERIT HIDRIT.

Ushtar Muharem Ferit Hidri, lindur në Katundin Dorëz të rrethit Librazhdit, më 1954 dhe sot banor në qytetin e Librazhdit, lagja Nr.2, Apartamenti 13. Mobilizuar nga Dega Ushtarake e Librazhdit dhe ardhur në repartin tonë, më dt.10.9.1975; vdiq aksidentalisht më datën 17.Janar.1977, rreth orës 5.00.

Gjatë kësaj kohe ka shërbyer në Repartin 9I25/4 dhe kohët e fundit me organizimin e ri u transferua në Repartin 9I25/5, me detyrën e Infermjerit.-

Rrethanat e vdekjes së tij, janë si më posht:

- Më datën 16 Janar 1977, është caktuar me shërbim roje ndërresa e dytë pran topave në pozicionet e zjarrit. Në ora 18.00 po të kësaj date është futur për të pushuar dhe është çuar për të marr shërbimin në ora 01.00 të datës 17 Janar 1977 nga përgjegjsi i rojeve ushtar [redacted] ky i fundit e ka çuar në vënd roje rreth orës 01.15'; roja dorzuse në këtë kohë ka qënë ushtar [redacted] i cili i ka ndalur në bazë të rregullores, mbas njohjes i ka bërë dorzimin e objektit që ruante ushtar Muharem Hidrit, duke qënë ndermjet topit të tret dhe të katërt.-

- Në ora 5.00, përgjegjsi i rojeve ka shkuar për ta hequr nga vënd roja, pasi ditën ky objekt sigurohet nga vrojtusi që kryen shërbim në PV. Përgjegjsi i rojeve ka shkuar në të katër pozicionet e topave duke kërkuar dhe duke i thirrur, por rojen nuk e gjeti. Duke menduar se mos e kishin zënë gjumi, në tunele, kthehet në P.V. për të marrë mjet ndriçimi, pasi në tunele ishte erësirë.

Në pikën e V. në këtë kohë ishte me shërbim N/oficer [redacted] ka i cili i ka dhënë një akumulator me një llambushk ndriçimi; me këtë është kthyer përsëri në pozicionet e zjarrit dhe kërkinin e rojes e ka filluar nga topi i katërt, ku aty gjeti edhe rojen të shtrirë në kanalën e zbra-



ka tundur, duke i folur, por mbasi nuk mori përgjigje dhe dora ishte e ftohët, kuptoj se kishte vdekur dhe niset me shpejtësi, del nga tuneli dhe lajmëron mbi ngjarjen vrojtusin n/oficer [redacted], rreth orës 6.00. Ky i fundit me njëher ka njoftuar komandantin e baterisë Oficer [redacted] i cili vete në vendin e ngjarjes i prek kufomës vetëm dorën për ti par pulsën dhe mbasi bindet se kishte vdekur, në orën 6.30 njofton O.O. të Rep. 9125.

Mbasi shkoi në vendin e ngjarjes grupi hetimor i Degës P. Mbrojtëse Vlorë dhe shok nga Komanda e repartit; rezultoj se:

- Roja duke hyrë në kokën e tunelit, ku ndodhet topi në pozicionin luftimi ka shkar në skrapatin ansor të kanalit të zbrapjes së topit, në krahun e majt të tij. Gjat rënësjes është përplasur në skrapatin e mbrapëm të kanalit në krahun e majt prapa veshit. Nga kjo goditje shënja të jashtme nuk ka, por vetëm kishte rrjedhje gjaku nga hundët e veshi i majt.

Kufoma u gjet shtritur në fundin e kanalit të zbrapjes e veshur me kapot e mushama shiu dhe pushkën mbi trup me dorën e djathtë tek doreza e gjytës.

Pushka u gjet me bajonet të përkulur dhe e mbushur me 10 fishe nën dhëmbin ndaluar e shkrepur dhe në sigures.

Kufomës mbasi ju bë autopsia, doli se shënja të jashtme në trup nuk kishte, por në bazën e poshtme të kokës kishte frakturë dhe emorragji në tru.

Nga analiza që i bëme në efektiv ngjarjes dhe kontrollin e dokumentave, doli se:

- Oficeri i rojes, [redacted] ka bërë instruktazhin e personelit të shërbimit ku ka marr pjesë dhe ushtar Muharem Hidri.

- Gjat instruktimit dhe më vonë deri në marjen e shërbimit nuk ka patur asnjë ankesë ose pretendim.

- Gjat natës në ora 00.45' oficeri rojes ka kontrolluar rojen dhe i ka gjetur në rregull, duke bërë edhe shënimet përkatëse në librin e shërbimit.-

- Gjat kësaj nate, deri në ora 2.00 koha ka qënë e keqe, ka patur reshje shiu, shkarkime atmosferike dhe ërë të fortë.

Gjat kryerjes së detyrës ushtarake ky ushtar ka qënë i disiplinuar dhe i sjellshëm me shokët e eprorët. Detyrën si infermier i baterisë (me gjithse nuk e zotronte këtë profesion) e ka kryer mirë. Nuk ka patur asnjë indisiplininë e grindje me shokët e eprorët, shërbimin e rojes e ka kryer mirë, për punë të mirë është shpërblyer me leje nga komanda, rasti i fundit ishte ay për vitin e ri 1977. Por me gjithë këto ci-

REKORDI I FUNDIT
RU 9125
1977
DOSJA 23, PL-3

ARIVI QENDROR I FA
FONDI Ru 9125
VTI 1977
DOSJA 23, Fl-4

ra e tij ishte të lëvizte para pozicionit të zjarrit.

Gjat analizës ne nxuarrëm dhe përgjegjsin tonë për një punë më intensive, sidomos me personelin e shërbimit, për njohjen e zbatimit e kërkesave të rregullores të jetës brëndëshme nga i gjithë efektivit dhe ushtrimin e kontrollit të her pas herëshme gjat kryerjes së shërbimit. Për këto mungesa e dobësi u vunë detyra konkrete për të ardhmen, por këtë ngjarje dëta analizojmë më hollësisht në rrugë partie e komande për të nxjerr detyra në kryerjen me vigjilenc të lartë të shërbimit dhe evitimin e ngjarjeve të jashtë zakonëshme.

KOMISARI REPARTIT USHTARAK 9125

/ RAMADAN ISMAILI /

Ramadan Ismaili

KOMANDANTI REPARTIT USHTARAK 9125

/ NEBI QELA /

Nebi Qela



A XVI QENDROR I FA